



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°4/2022

Hagë, 03/02/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, dëshmitari i fundit i thirrur prej Mbrojtjes së Haradinajt, përfundoi dëshminë e tij ditën e premte. Të hënën, më 31 janar u mbajt konferenca për ecurinë e çështjes gjyqësore me qëllim diskutimin e hapave të ardhshëm në këtë çështje, dhe pas konferencës Trupi Gjykses, duke mbajtur parasysh se nuk do të thirren më dëshmitarë dhe nuk do të paraqiten më prova, urdhëroi ekipet e Mbrojtjes të mbyllnin zyrtarisht paraqitjen e provave të veta.

Ditën e djeshme ekipet e Mbrojtjes mbyllën zyrtarisht paraqitjen e provave dhe pritet që Trupi Gjykses të nxjerrë një urdhër lidhur me hapat e ardhshëm në kohën e duhur.

Në gjykimin e Salih Mustafës, dëshmitari i fundit i thirrur prej Prokurorisë, një ish-anëtar i UÇK-së, filloi dëshminë ditën e martë dhe përgjatë dy ditëve të dhënies së dëshmisë atij i drejtuan pyetje Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtja. Dëshmitarit i bënë pyetje edhe gjykatësit. Dëshmitari dëshmoi lidhur me strukturat e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, njësitin BIA dhe rolin që ka luajtur z. Mustafa në atë njësit, si dhe lidhur me ofensivën serbe në zonën e Zllashit në muajin prill 1999.

Kryegjykatësja e Trupit Gjykses I ishte e pranishme me anë të videolidhjes për shkak të rregullave të karantinimit prej KOVID-19.

ZPS-ja do të mbyllë paraqitjen e provave më 4 shkurt 2022 me një njoftim zyrtar të dorëzuar për protokollim në dokumentacionin e çështjes.

Më 11 shkurt, Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave në çështjen *Salih Mustafa* do të dorëzojnë listat e tyre përkatëse të dëshmitarëve dhe provave materiale dhe, më 17 e 18 shkurt Trupi Gjykses I do të mbajë konferencën përgatitore për mbrojtjen dhe

1





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°4/2022

Hagë, 03/02/2022

konferencën për ecurinë e çështjes lidhur me viktimat. Pas kësaj, Trupi Gjykses do të vendosë për numrin dhe modalitetet e dëshmitarëve që do të japin dëshmi si dhe për datat dhe oraret e seancave.

Deri më tani, 27 dëshmitarë gjithsej kanë dëshmuar para gjykatës për dy gjykimet që janë në zhvillim e sipër para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në çështjen e z. Pjetër Shala, më 28 janar Prokurori i Specializuar dorëzoi dosjen e vet paraprake si dhe listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale. Parashtrimi i protokolluar i dosjes paraprake bashkë me listat shoqëruese është një hap i rëndësishëm që duhet ndërmarrë para se Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'ia kalojë dosjen e çështjes një trupi gjykses.

Gjithashtu më 28 janar, Administratorja caktoi z. Sajmon Loz për të përfaqësuar viktimat pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore *Shala*. Mbetet i hapur procesi që viktimat të parashtrojnë kërkesë për pjesëmarrje në procesin për këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, është planifikuar për ditën e nesërme më 4 shkurt, në orën 2:30 të pasdites. Gjatë kësaj seance, ndër aspektet që do të trajtohen përfshihet edhe nxjerrja e materialeve dhe ecuria e hetimeve nga Prokuroria dhe Mbrojtja.

Ndër lajme të tjera: në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuese, këtë javë zëdhënësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës morën pjesë në një panel virtual ku diskutuan monitorimin e proceseve gjyqësore, të organizuar prej Humanitarian Law Centre.

Zëdhënësit shpjeguan arsyet pse duhen redaktuar versionet publike të dokumenteve në çështjet gjyqësore dhe pse disa seanca gjyqësore mbahen private, ndonëse parimisht procesi gjyqësor është publik. Ata shpjeguan se masa të tilla urdhërohen prej gjykatësve, zakonisht me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve ose të viktimave.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°4/2022

Hagë, 03/02/2022

Sidoqoftë, vlen të theksohet se, në kuadër të parimit të gjykimit publik, parashtrimet e protokolluara konfidenciale rishikohen rregullisht dhe sa herë që nuk ka më arsye që përlijin konfidencialitetin e tyre, ato riklasifikohen si versione publike ose versione të redaktuara publike. Për shembull, parashtrimet e protokolluara lidhur me vizitën e fundit të z. Veseli si i paraburgosur, u bënë publike menjëherë pas vizitës.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

